

## PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATËS 25.01.2023

Kryesuesi i mbledhjes ështëzv.Kryetarii Këshillit znj. Edlira Mitre.

Ora e hapjes së mbledhjes: 13:00

Zhvillimi i mbledhjes: në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 21

Sekretari i Këshillit deklaroi kuorumin prej këshilltarësh: 21

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: 5

Të pranishëm në mbledhje qytetarë:

### **Pika 1 e rendit të ditës.**

#### **PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.**

Zv.Kryetari i Këshillit E.Mitre:Meqënëse shumica kuorumi u plotësua fillojmë mbledhjen e Këshillit Bashkiak. Hedhim në votim rendin e ditës. Kemi një propozim për një material shtesë të ardhur nga Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes që vijon në rradhën e materialeve të mëparshme pas pikës 9 “Për Miratimin e Subvencionimit të Qirasë për Familjeve të Pastreha”, mendojmë që të hyjë ky material “Për Miratimin e Bursave për Nxënësit e Arsimit Parauniversitar Për Vitin Shkollor 2022-2023 Në Institucionet Arsimore Publike. Jeni dakord me rendin e ditës të ndryshuar?

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 2 e rendit të ditës.**

#### **PËR MIRATIMIN E PROÇESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS28-DHJETOR2022.(me e-mail)**

Zv.Kryetari i Këshillit E.Mitre: Besoj se është parë. Ka ndonjë gjë nga këshilltarët?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 3 e rendit të ditës**

**MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6% E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE, DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR PERIUDHËN 1 – 31 DHJETOR 2022.**

**(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut) znj. Irena Nikaj.**

Këshilltari I. Nikaj: Propozoj miratimin e ndihmës ekonomike në relacionin e paraqitur nga Drejtore e Përgjithshme e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Drejtor i Kujdesit Social, Drejtore e Drejtorisë së Buxhetit dhe MFK. Për periudhën dhjetor janë 48 familje përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar. Këto familje, përzgjidhen nga ana e Administratorit Shoqëror sipas Njësive Administrative, nga familjet e pakualifikuara nga sistemi i pikëzimit me cilësimin, “Nuk ka marrë pikët e mjaftueshme” konkretisht për ato familje të cilat kanë paraqitur dosje të plotë dokumentacioni. Nga të gjitha familjet e pakualifikuara nga sistemi, për mos marrjen e pikëve të mjaftueshme, përfitojnë familjet me nivel më të ulët ekonomik, me probleme sociale dhe shëndetësore, personat mbi moshë pune, personat e vetmuar, familje me k/familjarë të ve ose divorcuar me të paktën një fëmijë, familjet romë dhe egjiptiane, sipas kriterëve të miratuara në mbledhjen e Këshillit Bashkiak me vendim nr. 5 për kriteret e buxhetit vendor dhe vendim nr. 4 për kriteret e 6%, datë 27.01.2022. Për muajin Dhjetor 2022, është në dispozicioni fondi prej 255.560 lekë si 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, nga sistemi i pikëzimit. Nga ky fond, përfitojnë 48 familje, të përzgjedhura sipas kriterëve specifike të miratuara, në shumën 158.277 lekë. Po nga ky fond përfitojnë kompensim të energjisë elektrike 20 familje, në shumën 25.112 lekë. Pagesa totale nga 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, plus energji, është 183.389 lekë. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i buxhetit vendor, sipas kriterëve specifike të miratuara 13 familje, me fond prej 47.697 lekë. Bazuar në Vendimet e mësipërme, përfituesit e kësaj kategorie, përzgjidhen kryesisht nga familjet e evidentuara nga administratorët socialë në nevojë ekstreme ekonomike dhe në kushte specifike sociale, pavarësisht cilësimit të sistemit elektronik të përzgjedhjes. Unë i propozoj Këshillit Bashkiak miratimin e kësaj ndihme ekonomike që është parashikuar për këtë muaj.

Zv. Kryetari i Këshillit E. Mitre: Nga këshilltarët ka diçka për të shtuar? Nga ekzekutivi?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

#### **Pika 4 e rendit të ditës**

**MBI MBËSHTETJEN FINANCIARE TË FAMILJEVE QË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA BUXHETI VENDOR, PËR ZBUTJEN E IMPAKTIT TË KRIZËS.**

**(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut) znj. Irena Nikaj.**

Këshilltare I.Nikaj: Bazuar nënenin 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 11, individët e pagesës së kufizuar, individët e statusit invalid paraplegjik dhe tetraplegjik, statusin e të verbrit, familjet me ndihmë ekonomike.Për të gjitha këto arsye, Bashkia Korçë, duke mos përjashtuar nga ky vendim, familjet të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike nga buxheti vendor, ka vënë në dispozicion një fond nga buxheti vendor i Bashkisë për zbutjen e impaktit të krizës edhe për këtë kategori, duke u mbështetur në ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, mbështetjen financiare për këtë periudhë, do ta përfitojnë vetëm familjet e listës fituese të muajit Nëntor 2022.I propozojmë Këshillit të Bashkisëqë:

1-Të përfitojnë mbështetje financiare, 13 familje nga buxheti vendor,në masën 5.000 (pesë mijë) lekë, me fond prej 65.000 lekë.

2-Fondi do të përballohet nga fondi i planifikuar në buxhetin e vitit 2023 për transferta tek individët, (Ndhmë ekonomike për familjet në nevojë), në programin AI122 Përkujdesi social (Bashkia), me këtë strukturë buxhetore:

Art. 6060000            65,000 lekë (transferta e pakushtëzuar)

Zv.Kryetari i Këshillit E.Mitre:Nga këshilltarët ka dicka për të shtuar? Nga ekzekutivi ? Është e sqaruar.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 5 e rendit të ditës**

"PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR FAMILJET NË NEVOJË QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE, NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR VITIN 2023.

**(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut) znj.Irena Nikaj.**

Këshilltare I.Nikaj:Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, ligjit nr.57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, neni 21 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndhmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike. Është e drejta e Drejtorisë së Kujdesit Social, të përzgjedhë, një numër familjesh nga kategoritë më në nevojë dhe të trajtojë ato me ndihmë ekonomike, nga buxheti i Bashkisë. Këto familje përzgjidhen nga aplikantët e listës së familjeve jo përfituese.Për këto familje , duhet të kryhet detyrimisht kontrolli në banesë dhe të shoqërohet me një vlerësim social-ekonomik nga një komision i përbërë prej tre administratorë

shoqërorë të Drejtorisë së Kujdesit Social dhe Përgjegjësit të Pagesave. Përfitues të fondit nga buxheti i Pushtetit Vendor do të jenë, familjet të cilat nuk kanë përfituar nga sistemi i pikëzimit dhe nga 6% i fondit të kushtëzuar. Por kualifikohen si përfitues për shkak të kushteve shumë të vështira social-ekonomike dhe vështirësive të veçanta sociale. Lista e familjeve do të miratohet me vendim të Këshillit Bashkiak në bazë të kriterëve specifike që propozohen në Projekt-Vendim dhe që janë përcaktuar duke marrë parasysh situatën konkrete social-ekonomike të disa nën/kategorive

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 6 e rendit tëditës**

"PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR FAMILJET NË NEVOJË QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE, ME 6% NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE, PËR VITIN 2023.

**(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut)** znj. Irena Nikaj.

Këshilltare I. Nikaj: Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, ligjit nr. 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë. Është e drejta e Drejtorisë së Kujdesit Social, të përzgjedhë , një numër familjesh nga kategoritë më në nevojë dhe të trajtojë ato me një fond deri në 6% nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike. Këto familje përzgjidhen nga aplikantët e listës së familjeve jo përfituese. Për këto familje , duhet të kryhet detyrimisht kontrolli në familje dhe të shoqërohet me një vlerësim social-ekonomik nga një komision i përbërë prej tre administratorë shoqërorë të Drejtorisë së Kujdesit Social dhe Përgjegjësit të Pagesave. Lista e familjeve do të miratohet me vendim të Këshillit Bashkiak në bazë të kriterëve specifike që propozohen në Projekt-Vendim dhe që janë përcaktuar duke marrë parasysh situatën konkrete social-ekonomike të disa nën/kategorive. Ftoj këshilltarët që ta miratojnë këtë material.

Zv. Kryetari i Këshillit E. Mitre: Nga këshilltarët ka diçka?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 7 e rendit të ditës.**

**MBI MIRATIMIN E DOKUMENTAVE TË PUNËS, PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE PËR FËMIJËT .**

**(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut) znj.Irena Nikaj.**

Këshilltare I.Nikaj: Në zbatim të Planit Social Vendor 2019-2022 dhe Planit Kombëtar të Deinsitucionalizimit 2020-2022 Bashkia Korçë me mbështetjen e Fondit Social 2021 të akorduar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe në partneritet me Shoqatën Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS, prej vitit 2021 ka ngritur Shërbimet Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen e cila është një strukturë në varësi të Drejtorisë të Kujdesit Sociali Bashkia Korçë , miratuar në Këshillin Bashkiak Nr 59. Datë 03.06.2021 “PËR MIRATIMIN E FONDIT PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT QENDRA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE PËR FËMIJËN DHE FAMILJEN ME BAZË KOMUNITARE” NË BASHKINË KORÇË TË FINACUAR NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE.Shërbimet Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen janë një ndërthurje midis shërbimeve parashoqërore, shërbimeve në qendrat komunitare, shërbimeve të specializuara dhe shërbimeve të emergjencës dhe funksionojnë në përputhje me standardet e shërbimeve komunitare shumëdisiplinare. Ngritja e këtij shërbimi ka qënë në përputhje me realitetin dhe nevojat e komunitetit në Bashkinë Korçë, duke ofruar shërbime të integruara për zhvillimin e fëmijëve, aftësive të tyre psikosociale dhe edukative si dhe mbështetje të specializuar për fuqizimin e prindërve dhe familjeve.Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet shoqatës Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS dhe Bashkisë Korçë e lidhur me datë 13.07.2021 me nr.prot 6013 dhe nr.101 prot,palët kanë hartuar një paketë të plotë dokumentash si në materialin e paraqitur. I propozojmëKB miratimin e paktës së plotë të dokumentave që kanë si qëllim sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të fëmijëve dhe familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror.

Zv.Kryetari i Këshillit E.Mitre: Nga ekzekutivi? Nga këshilltarët ka pyetje, diskutime?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 8 e rendit të ditës**

**MBI MIRATIMIN E VLERËS MAKSIMALE TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË DHE TË NIVELIT TË QIRASË MESATARE NË TREGUN E LIRË.**

**(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut) znj.Irena Nikaj.**

Këshilltare I.Nikaj: Në zbatim të programit “Subvencionimi i Qirasë” që zbatohet nga Bashkia Korçë paraqesim relacionin për vlerën maksimale të subvencionimit të qirasë ,që i përgjigjet

vlerës mesatare të qirasë në tregun e lirë në territorin e bashkisë sonë. Vlera maksimale e subvencionit të qirasë përcaktohet çdo vit, bazuar në të dhënat e vitit të mëparshëm, dhe miratohet me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Subvencioni i qirasë është një instrument i programit të banesave sociale me qira, që ndihmon individët/familjet, të cilët me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë sociale ose të qirasë reale. Masa e subvencionit përllongaritet në varësi të të ardhurave të familjes. Ky program i dedikohet kryesisht familjeve me pak ose pa të ardhura. Bashkëngjitur tabela me nivelin mesatar të qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave të apartamenteve në territorin e Bashkisë Korçë. I propozojmë Këshillit Bashkiak të miratojë nivelin mesatar të qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave të apartamenteve në territorin e Bashkisë Korçë, sipas tabelës bashkëngjitur.

Zv. Kryetari i Këshillit E. Mitre: Nga ekzekutivi? Nga këshilltarët ka pyetje, diskutime?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 9 e rendit të ditës**

PËR MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET E PASTREHA”.

**(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut)** znj. Irena Nikaj.

Këshilltare I. Nikaj: Subvencionimi i qirasë (bonusi i strehimit) është një instrument i programit të banesave sociale me qira, qëndihmon individët/familjet, të cilët me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë sociale ose të qirasë reale. Subvencionimi do të kryhet në bashkëfinancim me fonde të siguruara nga buxheti i shtetit nëpërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave bazuar në kufinj të financimit sipas Udhëzimit nr. 31. Raporti në bashkëfinancim është i detyruar jo më pak se 30% e fondit të nevojshëm, do të përballohet nga buxheti i bashkisë. I propozojmë Këshillit të Bashkisë Korçë të autorizojë:

- Subvencionin e qirasë për 22 familjet aplikante, sipas tabelës bashkëngjitur.
- Subvencionin i qirasë do t’i jepet përfituesit që nga data e lidhjes së kontratës.

Zv. Kryetari i Këshillit E. Mitre: Nga ekzekutivi? Mirela kemi gjë? Pyetje, diskutime rreth materialit?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

## **Pika 10 e rendit të ditës.**

**PËR MIRATIMIN E BURSIVE PËR ARSIMIN UNIVERSITAR PËR VITIN SHKOLLOR 2022-2023 NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE.**

**(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut) znj.Irena Nikaj.**

Këshilltare I.Nikaj:Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit e Çerdhes, duke u mbështetur tek pika 5 e këtij Vendimi të Këshillit të Ministrave nr 511 dhe pas miratimit të Buxhetit ekonomik finaciar të Bashkisë Korçë, kërkon miratimin dhe shpërndarjen e bursave të nxënësve që s'përfituan bursë (sipas kriterit ekonomik dhe jo-ekonomik të përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.666 dhe 511, dhe nga Vendimi nr.180 datë 28.12.2022 të Këshillit Bashkiak Korçë), si dhe duke u mbështetur në pikat e mëposhtme :Pika 16 e këtij vendimi ku shprehimisht thuhet: “Për nxënësit të cilët kanë përfituar bursë, drejtorët e shkollave të arsimit profesional si dhe të shkollave të tjera të arsimit parauniversitar dërgojnë zyrtarisht, në datën 5 të cdo muaji, pranë njësive të vetqeverisjes vendore, informacion për frekuentimin e shkollës/praktikës profesionale nga nxënësit që përfitojnë bursë. Pika 28 e këtij vendimi ku shprehimisht thuhet:”Masa e bursës dhe kuota financiare ushqimore ditore për nxënësit jepet, respektivisht, sipas pasqyrave nr.2 dhe nr.3 që i bashkëlidhet këtij vendimi “Masa e bursës për nxënësit e shkollave 9-vjeçare dhe të mesme është 332.7 lekë/ditë.Në relacion është paraqitur numrin i nxënësve të institucioneve arsimore që kërkojnë të marrin bursë sipas pikës 5 të Vendimit të Ministrave.Bashkëngjitur këtij relacioni janë vendosur edhe listat emërore të nxënësve për të përfituar bursë sipas shkollave dhe klasave. I ftoj këshilltarët që ta miratojnë këtë material.

Zv.Kryetari i Këshillit E.Mitre: Nga ekzekutivi? Këshilltarët?

Zv. Kryetar i Bashkisë K.Kita: Një sqarim qëështë sqaruar edhe tek relacioni qëështë paraqitur. Është të gjithë këta nxënës të shkollave 9-vjeçare 133 nxënës, bursën e plotë që përfitojnë, të gjithë kompesimin financiar do vijë nga buxheti i bashkisë. Kjo është lista që kanë dërguar pothuaj të gjitha shkollat, të cilët kanë plotësuar kriteret dhe do të përfitojnë bursën. E kemi diskutuar dhe në mbledhjet e kaluara tëKëshillit Bashkiak të cilët nuk e përfituan të gjithë për shkak të fondit që ishte dërguar nga Ministria dhe po e paraqesim këtë material që gjithë këtë fond për bursat ta mbulojmë nga buxheti i ri 2023 i Bashkisë Korçë.

Zv.Kryetari i Këshillit E.Mitre: Domethënë 350 i kishim dhe u shtuan 133 nxënës.

Zv. Kryetar i Bashkisë K.Kita: Po dhe do të mbyllet komplet e gjithë lista e dorëzuar në Ndërmarrjen Mbështetëse tëArsimit dhe të gjithë duhet të përfitojnë bursa në bazë të kriteve.

Zv.Kryetari i Këshillit E.Mitre: E desha këtë përgjigje për tu sqaruar dhe me publikun , që kjo shtesa që u bë mbulohet vetëm nga bashkia.

Këshilltare E.Tare: Nga ana ime si këshilltare, si qytetare dhe si komisionere një falenderim të veçantë dua ti jap kryetarit të bashkisë i cili ka bërë përpjekjen maksimale në bashkëpunim me drejtorinë mbështetëse që edhe këta fëmijë të përfitojnë.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

**Pika 11 e rendit të ditës.**

PËR RISHQYRTIMIN DHE LËNIEN NË FUQI TË V.K.B-së NR.179, DATË 28.12.2022 "PËR PËRCAKTIMIN E MASËS FINANCIARE PËR Z.ARDIAN DYLI, TË CILIT I ËSHTË DËMTUAR BANESA NGA RËNIA E ZJARRIT".

**(Komisioni i Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimit)** znj.Edlira Mitre, z.Julian Kodra, z.Ermir Petriti, znj.Majlinda Like, z.Dejvi Hoxha dhe **(Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare)** z.Julian Kodra, z.Joan Deli, znj.Mamica Nene, znj.Maria Dojçe.

Zv.Kryetari i Këshillit E.Mitre: E kemi material të kaluar, e kemi miratuar dhënien e ndihmës për z.Ardian Dyli por është një material i cili është kthyer nga Prefektura e Qarkut Korçë. Prefektura nuk e konfirmon vendimin e KB nr.179datë28.12.2022 "PËR PËRCAKTIMIN E MASËS FINANCIARE PËR Z.ARDIAN DYLI, me arsyetimin se ndihma financiare është më e lartë se vlera e dëmeve. Duhet llogaritur në vlerën 50% të dëmit të shkaktuar nga zjarri sipas prefekturës. Ndërkohë që materiali është i bazuar në ligj , në nenet përkatëse. Më poshtë e kemi të detajuar pika b) në rastet e dëmtimit të banesave private , masa e ndihmës bazohet në preventivin e bërë nga grupet e vlerësimit përlllogaritur me çmimet në fuqi, miratuar nga KM për rendin kombëtar të banesave dhe në mundësit financiare të organit të qeverisjes vendore, ministrisë së brendshme ose fondit rezervë të burimeve të buxhetit të shtetit apo dhe të burimeve të tjera, dhe pika d) në rastin e dëmtimeve në orendi, mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake, strukturave të banimit, masa e ndihmës llogaritet mbi bazën e çmimeve mesatarë për artikujt e caktuar nga strukturat e tatim taksave. Të gjitha këto ishin të bazuara në ligjin 45 të vitit 2019 "Për mbrojtjen civile" dhe materiali është i bazuar në ligj. Mendohet që kjo ndihmë të lihet në fuqi nga ana jonë, sepse dhe grupet që vajtën për inspektim dhe e panë, grupet e ngritura nga bashkia panë që gjendja ishte shumë e keqe dhe të dy bashkëshortët ishin me aftësi të kufizuara, të dy të verbër. Kemi menduar që të qëndrojmë në fuqi. Nëse keni pyetje,diskutime?

Këshilltare E. Menkshi: Në rast se kjo ngrihet në fuqi dhe çfarë ndodh nëse dhe ata i qëndrojnë asaj ?

Këshilltare A.Verushi: Kjo varet nga kontributi që i jep bashkia, dhe aq më tepër që i shtohet dhe ky problem social, aftësia e kufizuar.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0



## **Pika 12 e rendit të ditës.**

**PËR VLERËSIMET DHE PARASHIKIMET AFATMESME TË TË ARDHURAVE.**

**(Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare), znj.Mamica Nene.**

Këshilltari M.Nene: Është paraqitur relacioni në lidhje me vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave, dhe ky material është trajtuar në mënyrë të detajuar, politikat e hartimit të raportit për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme si dhe metodat e parashikimit të nivelit të të ardhurave në parashikimin afatmesëm. Vlen të theksohet se në ky parashikim , efektet në rritjen e të ardhurave vendore, për të tre vitet e ardhshme janë parashikuar me rritje në total për vitin 2026 prej 36,141 mijë lekë kundrejt planit të vitit 2023, mesatarisht 12,047 mijë lekë në vit. Të ardhurat nga burimet e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat vendore, të ardhurat nga tarifatat vendore dhe të ardhurat e tjera të cilat janë planifikuar me një rritje mesatare prej 1 % nga viti në vit. Për të qënë sa më afër realitetit është mbajtur parasysh edhe realizimi faktik i të ardhurave në dy vitet e fundit 2021-2022, detyrimet debitore të krijuara ndër vite, për të cilat në momentin e planifikimit përmbledhet vetëm periudha 18 muaj nga faturimi si dhe trendi i zgjerimit të bazës së taksueshme. Peshën më të konsiderueshme në parashikimin që janë vënë në materialin e zënë të ardhurat nga taksat vendore me 57.8% i totalit dhe konkretisht në kategoritë e taksave që ndikojnë më shumë në planin e të ardhurave janë:

Taksa mbi pasuritë e paluajtëshme (ndërtesë, truall, tokë bujqësore) e cila zë rreth 24.1 % të planit në total :

- 1) Taksë ndërtese zë 16.6 % të planit
- 2) Taksë mbi truallin zë 2 % të planit
- 3) Taksë mbi tokën bujqësore zë 5.5 % të planit

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja dhe legalizimet të cilat zënë rreth 22.8 % të planit në total. Të ardhurat nga tarifatat vendore të parashikuara zënë 36.9 % të totalit dhe në material është paraqitur gjithashtu shumica e detajuar dhe cilat janë kategoritë qëndikojnë më shumë në planin e të ardhurave duke ju referuar tarifës të pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit, mirëmbajtjes së varrezave publike të cilat zënë rreth 27.8 % të planit në total. Tarifa për zënien e hapësirës publike, tarifa e parkimit dhe tarifa vjetore e shërbimit dhe mirëmbajtjes të rrugëve të parcelave dhe të sistemit kullues të cilat zënë rreth 7.2 % të planit në total dhe pjesa tjetër janë të ardhura të tjera që zënë 5,3% të totalit .Kategoritë e taksave të ndara që ndikojnë më shumë në planin e të ardhurave janë të ardhurat nga taksat e ndara (taksa e regjistrimit të përvitshëm të automjeteve, tatim shitje pasuri e paluajtëshme, tatim mbi të ardhurat personale) të cilat zënë rreth 9 % të planit në total. Bashkëngjitur këtij relacioni është vënë tabelën me parashikimet afatmesme të të ardhurave për periudhën 2024-2026. Ftoj këshillin bashkiak që ta miratojë këtë material.

Zv.Kryetari i Këshillit E.Mitre: Nga ekzekutivi? Nga këshilltarët, pyetje, diskutime?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

**Pika 13 e rendit të ditës.**

PËR NJË SHITESË MBI NUMRIN E PËRGJITHSHËM TË PUNONJËSVE TË ADMINISTRATËS TË BASHKISË KORÇË.

**(Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative dhe Pasurive të Bashkisë)**  
z.Gjergji Kristo

Këshilltar Gj.Kristo: Bazuar në Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 183 datë 28.12.2022 është miratuar buxheti vjetor 2023, në të cilin në pikën 6 është miratuar numri total i punonjësve të Bashkisë Korçë 378 punonjës. Bashkia Korçë kërkon që të zhvillojë një program internship. Në bazë të këtij programi Bashkia synon të punësojë një numër pre 10 personave, kryesisht të rinj të sapodiplomuar. Qëllimi i këtij programi është nxitja e punësimit të të rinjve, rritja e numrit të forcës së punës, dhënien e mundësisë për t'u njohur dhe punësuar në administratën publike vendore, kualifikimi profesional dhe fitimin e eksperiencës. Efektet financiare do të përballohen nga buxheti i Bashkisë Korçë i miratuar për vitin 2023.

Zv.Kryetari i Këshillit E.Mitre: Ka pyetje?

Këshilltare E.Menkshi: I keni të përcaktuara pozicionet e intershipit apo thjesht si numra në total, kjo për interes për të përfshirë studentë të cilët mund të interesohen.

Ekezkutivi A.Dishnica: Është thjesht përcaktimi i numrave dhe më pas do diskutohet me kryetarin për pozicionet në bashki por besoj se do jenë tek turizmi dhe tek marrëdhëniet me publikun.

Zv.Kryetari i Këshillit E.Mitre: Pyetje të tjera diskutime?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

**Pika 14 e rendit të ditës.**

PËR MIRATIMIN E PLANIT VJETOR TË PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL PËR INSTITUCIONIN E BASHKISË KORÇË PËR VITIN 2023

**(Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative dhe Pasurive të Bashkisë)**  
z.Gjergji Kristo

Këshilltar Gj.Kristo: Bazuar në nenin 18 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 108 datë 26.02.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil” çdo institucion i administratës shtetërore duke përfshirë edhe vetëqeverisjen vendore, përgatitin planin vjetor të nevojave për rekrutim në shërbimin civil. Në planin vjetor të pranimit në shërbimin civil duhet të parashikohen numri i vendeve vakante për të cilat duhet të shpallet konkurimi për çdo kategori dhe klasë, numri i anëtarëve të TND ( trupa e nëpunësve të nivelit të lartë drejtues) si dhe grupet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm. Bazuar në urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Korçë nr. 26 datë 13.01.2023 “Për miratimin e strukturës së administratës së Bashkisë Korçë për vitin 2023” numri i vendeve vakante, pjesë e shërbimit civil në Bashkinë e Korçës për këtë vit është 86. Nga këto pozicione 1 vend vakant për nëpunës të kategorisë së lartë drejtuese ( drejtor drejtorie të përgjithshme), 7 janë vende vakante për nëpunës të nivelit të mesëm drejtues (drejtor drejtorie), 17 janë vende vakante për nëpunës të nivelit të ulët drejtues ( përgjegjës sektori) dhe 61 janë vende vakante për nëpunës të nivelit ekzekutiv (specialistë). I propozojmë këshilltarëve ta miratojnë.

Zv.Kryetari i Këshillit E.Mitre: Nga ekzekutivi? Pyetje, diskutime?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 15 e rendit të ditës.**

**PËR DHËNIEN ME HUAPËRDORJE MINISTRISË SË MBROJTJES TË ISH ZYRAVE TË QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT ME NR.PASURIE 2/55 ZK 8564 ME SIPËRFAQE 17.3 M2 SIPAS PLANIMETRISË BASHKANGJITUR.**

**(Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative dhe Pasurive të Bashkisë)**  
z.Gjergji Kristo.

Këshilltar Gj.Kristo: Bashkia Korçë ka në pronësi pasurinë nr. 2/55 ZK 8564, e llojit ndërtesë, me sipërfaqe 17.3 m2, ZK 8564, me adrese Lagjia 7 Rruga Ismail Qemali, objekti nr.3, hyrja 21, kodi postar 7001 Korçë, në bazë të VKM nr.1532 datë 19.11.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Korçë të Qarkut të Korçës” e ndryshuar. Në këtë objekt ka ushtruar veprimtarinë administrative Qendra Kombëtare e Biznesit. Ministria e Mbrojtjes me anë të kërkesës për bashkëpunim që i ka dërguar Bashkisë Korçë i ka kërkuar kësaj të fundit të vendosë në dispozicion një ambient në kuadër të procesit të rekrutimit të kandidatëve për ushtarë/detarë aktivë por edhe rezervistë në Forcat e Armatosura për një afat deri në 10 (dhjetë) vjet.

Zv.Kryetari i Këshillit E.Mitre: Ku është kjo mund ta di.

Zv Kryetar i Bashkisë K.Kita: Tek ish dyqani i luleve, ku është Drejtorja e kujdesit social.

Zv.Kryetari i Këshillit E.Mitre: Nga këshilltarët ka gjë për të shtuar?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

**Pika 16 e rendit të ditës.**

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES ME QIRA, TË AMBIENTIT ME SIPËRFAQE 98 M2 TË NDODHUR NË PALLATI I SPORTIT "TAMARA NIKOLLA" PJESË E PASURISË NR.1/12 ZK 8561, SIPAS GENPLANIT BASHKANGJITUR.

**(Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative dhe Pasurive të Bashkisë)**  
z.Gjergji Kristo.

Këshilltar Gj.Kristo:Bashkia Korçë është pronare e pasurisë nr.1/12 ZK 8561, me emërtim "Pallati i Sportit Tamara Nikolla". Pjesë e kësaj pasurie është sipërfaqja prej 98 m2 identifikuar sipas planimetrisë bashkangjitur këtij materiali.Bashkia Korçë, me qëllim realizimin e funksioneve të saj në fushën e zhvillimit ekonomik vendor, propozon fillimin e procedurave të dhënies me qira të sipërfaqes 98 m2, pjesë e pasurisë nr.1/12 ZK 8561 për qëllime biznesi.Me qëllim vazhdimin e shfrytëzimit të këtij objekti në pronësi publike të Bashkisë Korçë, dhe me misionin e një menaxhimi sa më eficient të aseteve të saj, i propozojmë Këshillit Bashkiak Korçë të miratojë fillimin e procedurave për dhënie me qira të kësaj pasurie.Tarifa e qirasë mujore me te cilën do të jepet me qira kjo pasuri është me një vlerë minimale prej 510.2 lekë/m2.I propozojmë Këshillit Bashkiak që ta miratojë këtë relacion.

Zv.Kryetari i Këshillit E.Mitre: Tek shërbimi social i Argjirit. Ndonjë gjë nga ekzekutivi?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

**Pika 17e rendit të ditës**

PËR DHËNIEN E TITULLIT "QYTETAR NDERI" AT GARY ËALSH.(materiali me e-mail)

**(Komisioni i Titujve të Nderit)** z.Pandi Bello

Këshilltar P.Bello: Komisioni vlerëson këtë figurë të rëndësishme në qytetin e Korçës, për mbështetjen dhe ringritjen e Kolegjit Preca në periudhën e vështirë të ngjarjeve të vitit 1997, përkrahjen dhe mbështetjen e grupeve në nevojë Jemi dakord që të marrë titullin Qytetar Nderi. Ka dhënë një kontribut të madh në dhënie e ndihmave për familjet në nevojë.

Zv.Kryetari i Këshillit E.Mitre: Nga këshilltarët ka diskutime?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 18 e rendit të ditës**

SIPAS KËRKESË TË SHOQËRISË "QËNDRA SPORTIVE KORÇË".SH.A. PËR THIRRJEN E ASMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONERËVE PËR SHQYRTIMIN E MATERIALIT SI MË POSHTË:

- PËR MIRATIMIN E TRAJTIMIT USHQIMOR DHE DIETAVE PËR EKIPIN E PARË DHE AKADEMINË "SKËNDERBEU" PËR VITIN 2023.

- PËR EMËRIMIN DHE MIRATIMIN E SKEMËS TË SHPËRBLIMEVE TË EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR PËR AUDITIMIN LIGJOR TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN 2022.

**(Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare)znj.Mamica Nene.**

Zv.Kryetari i Këshillit E.Mitre: Kalojmë si Asamble Aksioneri. Trajtojmë pikën e parë.

Këshilltare M.Nene:Nën cilësinë e Administratorit të “Qendra Sportive Korçë” sh.a, në mbështetje të Ekipit të Parë dhe Akademisë “Skënderbeu”, në nenin 135 të ligjit 9901 datë 14.04.2008 « Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare », i ndryshuar si dhe ne Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqërisë duke ju referuar listës të federimit numri i të cilës i kalon 30 persona, nevojës që ekipi i Skënderbeut ka për mbështetje financiare në arritjen e rezultateve, kërkoj miratimin e fondit në vlerën 50.000 lekë në muaj për person, për 30 sportistë (futbollistë dhe staf), për 10 muaj dhe dietën ditore për ekipin e parë dhe Akademinë “Skënderbeu”. Kjo pagesë do të kryhet nga Bashkia duke e transferuar fondin tek “Qendra Sportive Korçë” sh.a. “Qendra Sportive Korçë” sh.a detyrohet sipas transferimit të mësipërm të bëjë pagesën mujore për 30 sportistë të federuar (lista do të jetë e firmosur nga drejtuesit e klubit të futbollit “Skënderbeu”), për 10 muaj. I propozojmë këshillit bashkiak ta miratojë këtë pikë.

Zv.Kryetari i Këshillit E.Mitre: Nga këshilltarët ka diçka?

Zv. Kryetar i Bashkisë K.Kita: Me pak fjalë kjo është si formë detajimi, se ne e miratojmë transfertën, kjo është detajimi se sa kalon në dieta dhe sa kalon nëtrajtim ushqimor.

Zv.Kryetari i Këshillit E.Mitre: Ka diçka tjetër për të shtuar?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Zv.Kryetari i Këshillit E.Mitre: Vazhdojmë me pikën tjetër:

**PËR EMËRIMIN DHE MIRATIMIN E SKEMËS TË SHPËRBLIMEVE TË EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR PËR AUDITIMIN LIGJOR TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN 2022.**

Këshilltare M.Nene:Bazuar në nenin 135 pika 2 gërma (ç) të ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare”, ligjit 10 091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, në Statutin e Aktin e themelimit të shoqërisë “Qendra Sportive Korçë” sh.a i kërkon Asamblesë të Përgjithshme të Aksionerëve të propozojë dhe të emërojë ekspert kontabël të autorizuar, si dhe të miratojë skemën e shpërblimeve të këtyre ekspertëve për auditimin ligjor të pasqyrave financiare për vitin 2022 të Qendra Sportive Korçë sh.a.

Këshilltare A.Verushi: Në emër të këshilltarëve për të vazhduar me dakordësimet që kemi dhënë vitin e kaluar, kanë qënë znj Ilda Konomi dhe znj. Etleva Ashiku.

Zv.Kryetari i Këshillit E.Mitre: Ka diçka tjetër për të shtuar? Hedhim në votim pikën bashkë me emrat? Hidhet në votim pika e dytë e pikës 18.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 19 e rendit të ditës**

**SIPAS KËRKESË TË SHOQËRISË " KORÇA 2008 ".SH.A. PËR THIRRJEN E ASMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONERËVE PËR SHQYRTIMIN E MATERIALIT SI MË POSHTË:**

**- PËR EMËRIMIN E EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR SIPAS SKEMËS SË SHPËRBLIMEVE PËR AUDITIMIN LIGJOR TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN 2022 "KORÇA 2008" SH.A.**

**(Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare)znj.Mamica Nene.**

Zv.Kryetari i Këshillit E.Mitre: Jemi përsëri si Asamble Aksionere. Fjalën e ka Ana, bëjmë propozimet.

Këshilltare A.Verushi: Përsëri në emër të këshilltarëve, ne jemi për vazhdimësinë e të njëjtit grup ekspert kontabël sic janëznj Ilda Konomi dhe znj. Etleva Ashiku.

Këshilltare M.Nene:Bazuar në nenin 135 datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare”, i ndryshuar dhe gërma (d) për miratimin e skemës së shpërblimeve, ligjit 10 091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, në Statutin e Aktin e themelimit të shoqërisë “Korça 2008” sh.a i

kerkon Asamblesë të Përgjithshme të Aksionerëve të propozoj emerimin e ekspert kontabël të autorizuar për auditimin ligjor të pasqyrave financiare për vitin 2022 të “Korça 2008” sha.a si dhe numrin e eksperteve ne reference te ketij ligji.

Zv.Kryetari i Këshillit E.Mitre: Hedhim në miratim pikën e shpërblimeve dhe dy emrat që propozoi Ana.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

## **Pika 20 e rendit të ditës**

### **KËRKESA-ANKESA**

Zv.Kryetari i Këshillit E.Mitre: Kemi dy kërkesa të ardhura në drejtim të Këshillit Bashkiak. Do mundohem ti përmbledh. Njoftim dhe kërkesë për informacion Bashkisë Korçë dhe Këshillit Bashkiak, për dijeni z.Danjel Frashëri. Bazuar në nënin 32/1 dhe nenin 33 të ligjit 2022 të vitit 2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi të ndryshuar pranë komisionerit për mbrojtjen nga diskriminimi. Është paraqitur ankesa me nr.08 datë 11.01.2023 z.Daniel Frashëri kundër bashkisë Korçë dhe Këshillit Bashkiak Korçë me pretendimin për diskriminimin për shkak të racës, gjendjes ekonomike dhe gjendjes civile. Sipas shpjegimeve të dhëna subjekti ankues përveç të tjerash informon që është i divorcuar me dy fëmijë të cilët janë në kujdestarinë e tij, jeton me nënën e tij e cila është e verbër dhe përfiton pagesë kujdestarie, është i papunë dhe nuk merr ndihmë ekonomike sepse i kërkohet të rregjistrohet si punëkërkuar i papunë, ndërkohë që është shoqëruar i nënës gjë e cila e pengon që të kërkojë punë dhe të sigurojë të ardhura të tjera në familje. Ka dy fëmijë të moshës 11 dhe 8 vjec. Të dy fëmijët janë nxënës në shkollën 9-vjecare Asdreni. Mbështetur në VKM 511 datë 27.07.2022 “ Për përfitimin e bursave të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar të ndryshuar, kam aplikuar pranëNdërrmarjes tëShërbimeve Mbështetëse tëArsimit dhe çerdhes Bashkia Korçë duke dorëzuar të gjithë dokumentacionin përkatës dhe tani më thonë që nuk jeni përfitues. Fëmijët e mi me vështirësi të madhe ekonomike i çoj në shkollë që të edukohen dhe të arsimohen. Po ju drejtohem ju si institucion që të më zgjidhet problem pasi shoh që kudo ku kam shkuar nuk më hapen dyert dhe më diskriminojnë dukë mos më dhënë qoftë edhe një mundësi për të shpejguar arsyen. Listat janë miratuar me VKB i cili u mblodh në datën 23.12.2022. Ka lidhje me materialin që miratua herën e kaluar?

Zv Kryetari i Bashkisë K.Kita: Janë përfitues në listën e dhjetorit, nuk e di pse ka ardhur kjo ankesë. Të dy fëmijët janë në listë.

Këshilltare I.Nikaj: Siç është vënë re KB është përpjekur vazhdimisht për të ndihmuar këto grupe social në nevojë dhe siç e shihni dhe nga kërkesa e qytetarëve ai ka disa përfitime dhe i janë njohur disa përfitime që tregojnë se nuk i janë mbyllur dyert. Unë nuk e di tani secili ka të drejtë të shprehet sipas mënyrës se si e shikon çështjen, por nuk mendoj që të gjitha këto që janë thënë dhe janë përmendur të konsiderohen që nuk i janë hapur dyert dhe nuk është dëgjuar. Tjetër

çështje të cilën e sqarova dhe me sekretaren, unë do të doja disa përfaqësues, të ishin këtu ta verifikonin. Ne si komision mund ti kishim mirëpritur të gjitha këto kërkesa. Dhe në raste të tjera ky komision mund të ishte një vend i përshtatshëm që kjo ankesë të ishte depozituar dhe ne ta shqyrtonim dhe të kishim mundësi që të administrojmë edhe dokumentacione të tjera të cilat duhen, sepse nga ajo që kemi parë dje është folur me fjali të tipit që nuk janë serioze. Ne jemi këshilltarë, ka një rregullore ka një ligj të qeverisjes vendore që përcakton saktësisht cilat janë detyrat tona. Meqënëse jemi për çështje që unë i shikoj me shumë shqetësim, nëse ne i bëjmë detyrat ashtu siç duhet si këshilltarë dhe pastaj këto ti ndajmë atributet e institucioneve. Pra unë jam plotësisht dakord që të zbatohen përgjegjësitë që ka dhe do të doja me shumë mirësi që ne të përpiqemi ta bëjmë sa më mirë detyrën e këshilltarit dhe të përpiqemi të ndalojmë sa më shumë dhe të përfaqësojmë komunitet mbi bazën e përcaktimit dhe natyrisht t'ju përgjigjemi të gjitha kërkesave të qytetarëve, të gjitha nevojave që ata kanë me ato mundësi që ne kemi. Unë nuk e shikoj thjesht si një çështje që më shqetëson vetëm mua, por duke qënë se u bë sistematikisht një shqetësim i tillë mua më duket e rëndësishme që ne ta diskutojmë. Pra cilat janë qoftë komisioni që ne ngremë për ndihmën ekonomike sociale, respektimi i të drejtave të njeriut dhe do të ishte shumë mirë që ne të shikonim ku janë shkelur të drejtat, sepse atje thuhet janë fyer, nuk respektohen, diskriminohen, nëse ka specialistë dhe jurist ti shikojnë këto ku janë shkelur etj. Po të flasim me numra do të shikoni se nuk është një. Unë e thashëgjëni njëbotim të fëmijëve në bashkisë Korçë dhe të shikojmi cilat janë numrat realë dhe si përfitojnë të gjitha ato grupet që kanë nevojë për përfaqësimin e tyre, nevojat e tyre. Mund të shikojmë realisht se çfarë ndodh me bashkinë Korçë, sa është mbështetja dhe sa ka ndihma financiare për grupet në nevojë, grupet e marxhinalizuara, përfaqësuesit e komuniteteve.

Zv Kryetare e Këshillit E.Mitre: Do të shtoja dhe diçka tjetër përveç këtyre që tha profesore Irena. Ne të tërë si këshill e kemi pasur bonsensin për të miratuar të gjitha këto nismat ose çfarë kanë ardhur nga bashkia në ndihmë të fëmijëve, nuk kemi kthyer mbrapsht asnjë emër. Madje edhe herën e fundit që u bë bashkia morri iniciativën për të shtuar emra, dhe ne jemi ata që po i miratojmë. Pra e kemi bonsensusin për ti ndihmuar këta fëmijë, kështu që mendoj që kjo letra sikur nuk ka shumë vend për, gjithësesi nëse ai e ka emrin në listë kjo është gjeja më e mirë që ka ndodhur.

Këshilltare I.Nikaj: Imazhi i bashkisë dhe këshillit nuk është ngritur për shkak se ne kemi bërë gjithë këtë gjë, ky është problemi që më shqetëson, që figura e bashkisë e përfaqësuesve të institucioneve nuk është në dritën pozitive pavarësisht të gjithë atyre përpjekjeve dhe projekteve që ne kemi, dhe kjo nuk është fare e përshtatshme.

Sekretare E.Naçi: Pasi kemi adresuar kërkesën e kam lexuar dhe mes të tjerash kam parë që kudo që kam shkuar më janë mbyllur dyert. Në fakt tek ne, në Këshilli Bashkiak nuk ka ardhur asnjë kërkesë apo as edhe personi fizikisht që të kërkojë. Pasi u vumë në lëvizje nga shkresa bashkë më ndërmarjen kërkua që të dy fëmijët e zotërisë ishin të miratuar me vendimin nr 180, e kam këtu vendimin edhe listën tek shkolla Asdreni. Nuk e di nga e ka marrë informacionin që nuk i kishte fëmijët në listë.

Këshilltare A.Verushi: Kush e ka sjellë këtë ankesë? Dikush e ka sjellë.

Këshilltare E.Tare: Unë nuk e dija si ishte problem, direkt ka shkuar në Tiranë. Është një numër shumë i madh ankesash dhe prandaj thashë falë kryetarit dhe pritjes që u ka bërë dhe mundësisë së zgjidhjes se ishte një numër i paparë ankesas. Problemi është se personi kishte shkuar në shkollë për të parë listën. Shkolla i kishte thënë që nuk e ke emrin, domethënë ishte shko këtu



shko këtu, ndërkohë i kishte thënë dhe drejtorja mbështetëse. Drejtorja mbështetëse i thotë se nuk i kam listat i kam cuar në shkollë dhe ka qënë kjo sorollatje që ai është drejtuar direkt tek komisioneri dhe jo tek unë. Nëse do të kishte erdhur tek unë personalisht si specialiste e zyrës që jam këtu, puna do të ishte zgjidhur dhe nuk do të kishte ardhur si ankesë, por do të kishte ngelur sic ngelën të tjerat. Dhe rasti tjetër që është.

Zv Kryetare e Këshillit E.Mitre: Po kjo është znj.Brunilda Trimi dhe ajo ka një fëmijë është e divorcuar dhe jeton vetëm me vajzën e cila ka kujdestarinë e saj dhe ndjek studimet në klasën e 2 dhe pretendon që nuk është trajtuar, ndërkohë që edhe kjo është në listë besoj.

Këshilltare E.Tare: U miratua në lista e sotme e bashkisë. Ajo është më mbiemër Trimi ndërsa vajza kishte mbiemrin e babait dhe e kemi gjetur me Evën dhe i kemi thënë cili është personi. Pra meqënëse është dhe për të dy rastet, meqënëse subjekti që pretendohet “ të jetë diskriminuar” që në këtë rast për ne nuk është dhe për këshillin por atë që thashë me këtë që ne bëmë, me miratimin e këtyre bursave i dhamë përsëri një imazh shumë të mirë bashkisë, këshillit bashkiak dhe gjithë Korçës që nuk ka diskriminim. Pra qëçdo gjë mbyllet dhe trajtohet në mënyrën që duhet.

Zv Kryetare e Këshillit E.Mitre: Këto ishin dy kërkesat. Kalojmë tek pika të ndryshme nëse keni dicka? Faleminderit për pjesëmarrjen, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva Naçi

**KRYETARI**  
**ERJON NEXHIPI**